



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI I TIRANËS

### KRITERET E PRANIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019 NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Kriteret e miratuara nga Universiteti i Tiranës, për pranimet në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2018-2019, janë si më poshtë:

#### I. Fakulteti i Drejtësisë

- 1.1 Nota mesatare e përgjithshme (mesatare e thjeshtë) e cila përbëhet nga nota mesatare e të gjithë viteve të shkollës së mesme (përfshirë edhe notat e provimeve të maturës shtetërore), të cilat përbëjnë **50 % të vlerësimit**.
- 1.2 Nota mesatare e lëndëve të mëposhtme, të cilat përbëjnë **50 % të vlerësimit**:
  - a. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe 10 %
  - b. Histori 10 %
  - c. Qytetari 10%
  - d. Ekonomi 10%
  - e. Gjuhë e Huaj (e parë ) 10%

#### II. Fakulteti i Ekonomisë

- 2.1 Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), të cilat përbëjnë **50 % të vlerësimit**.
- 2.2 Nota mesatare e gruplëndëve (për të gjithë vitet gjatë të cilave shtrihen lëndët, përfshirë notat e maturës shtetërore), të cilat përbëjnë **50 % të vlerësimit**:
  - a. Matematikë 15%
  - b. Ekonomi 15%
  - c. Fizikë 10%
  - d. Gjuhë e Huaj 10%

#### III. Fakulteti i Shkencave të Natyrës

- 3.1 Mesatarja e thjeshtë aritmetike e përgjithshme **50% e vlerësimit**, e cila përbëhet 25% nga mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë dhe 25% mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të maturës shtetërore.
- 3.2 Nota mesatare e gruplëndëve **50 % e vlerësimit** (kurrikula bërthamë). Në gruplëndët përfshihen lëndët me përqindjet përkatëse :
  - 3.2.1 *Programi i studimit* **Biologji**
    - a. Biologji 30%
    - b. Kimi 10%
    - c. Fizikë 5%
    - d. Matematikë 5%

3.2.2 *Programi i studimit* **Bioteknologji**

- a. Biologji 20%
- b. Kimi 10%
- c. Fizikë 10%
- d. Matematikë 10%

3.2.3 *Programet e studimit* **Kimi; Kimi Industriale dhe Mjedisore; Kimi dhe Teknologji Ushqimore**

- a. Kimi 20%
- b. Biologji 10%
- c. Fizikë 10%
- d. Matematikë 10%

3.2.4 *Programi i studimit* **Matematikë**

- a. Nota mesatare e tri viteve të lëndës Matematikë 50%

3.2.5 *Programi i studimit* **Fizikë**

- a. Fizikë 20%
- b. Matematikë 20%
- c. Kimi 5%
- d. Biologji 5%

3.2.6 *Programi i studimit* **Informatikë; Teknologji Informacioni dhe Komunikimi**

- a. Matematikë 25%
- b. TIK 10%
- c. Fizikë 10%
- d. Biologji 5%

3.2.7 *Programi i studimit* **Inxhinieri Matematike dhe Informatike**

- a. Matematikë 30%
- b. Nota mesatare e matematikës në maturën shtetërore 20%

**IV. Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë**

- 4.1 Vlerësohet me **80 %** të rezultatit përfundimtar mesatarja aritmetike e tre viteve të studimit në shkollën e mesme
- 4.2 Vlerësohet me **20 %** të rezultatit përfundimtar mesatarja aritmetike e lëndëve të Maturës Shtetërore

**V. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**

- 5.1 Mesatare e thjeshtë e cila rezulton nga mbledhja aritmetike e notave të tre viteve dhe notave të marra në provimet e maturës shtetërore pjestuar me numrin në total të notave të mbledhura

**VI. Fakulteti i Shkencave Sociale**

- 6.1 Nota mesatare aritmetike e tri viteve të shkollimit **50% e vlerësimit**
- 6.2 Nota mesatare aritmetike e tri provimeve të maturës të detyrueshme ( Gjuhë-Letërsi, Matematikë, Gjuhë e huaj ) **40% e vlerësimit.**

- 6.3 Një provim me zgjedhje nga lista e provimeve me zgjedhje **10% e vlerësimit:**
- a. Qytetari
  - b. Sociologji
  - c. Filozofi
  - d. Psikologji
  - e. Histori ( nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
  - f. Gjeografi ( nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
  - g. Biologji ( nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
  - h. Ekonomi ( nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
  - i. Teknologji ( nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)

*Shënim : Nëse maturanti jep dy provime me zgjedhje nga lista e kriterit 6.3 atëherë llogaritja bëhet duke marrë notën mesatare të tyre.*

## **VII. Filiali Sarandë**

- 7.1 Kriteret e pranimit për të dy programet e studimit të Filialit Sarandë do të jenë të njëjtat me kriteret që do të kenë Fakultetet bazë .
- 7.2 Fakulteti i Ekonomisë programi Administrim Biznesi
- 7.3 Fakulteti i Gjuhëve të Huaja programi Gjuhë Angleze